



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate



# RAPORT mbi AKTIVITETIN e KI 2019

PËR NJË DIALOG  
TË QËNDRUESHËM  
PËRMES ANGAZHIMIT  
AKTIV TË AKTORËVE

# Përmbajtja

**06** Hyrje

**10** Klima e Investimeve

**12** Mbledhje Plenare

**18** Tryeza Konsultimi

**21** Rekomandime të përmbushura gjatë 2019

**25** Komunikim dhe vizibilitet

**26** Angazhimi i aktorëve

**28** Të tjera

**32** Planet për të ardhmen

**34** Numra të rëndësishëm, 2019

**35** Anëtarë të KI gjatë 2019



**KRYETARE E  
KËSHILLIT TË  
INVESTIMEVE**

“Platformat e komunikimit me palët e interesuara, siç është Këshilli i Investimeve, janë mjete efikase me ndikim në hartimin e politikave dhe zhvillimin ekonomik.”

**Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, 15 nëntor 2019**

# Objektivat për 2019

	Të ruajë <b>besimin e partnerëve</b> mbi efikasitetin e platformës		Të mbetet një <b>instrument efikas</b> për reformat në vend	
<b>Avokim</b> për zgjidhjen e pengesave të biznesit përmes rekomandimeve gjithëpërfshirëse		<b>Rrisë angazhimin</b> e aktorëve		
	Përmirësojë <b>procesin e monitorimit</b> mbi zbatimin e rekomandimeve të KI		Ndikojë në uljen e <b>barrës administrative</b> dhe kostos së pajtueshmërisë për biznesin	
<b>Propozojë ndërhyrje</b> për zbatimin e rekomandimeve të KI duke lehtësuar përshpejtimin e reformave		<b>Axhendë gjithëpërfshirëse</b> përmes votimit dhe konsultimit me qëllim strukturimin e dialogut dhe trajtimin e fushave të reja me përparësi		
	Publikojë në kohë dhe mënyrë <b>transparente</b> materialet e KI		<b>Rrisë ndërgjegjësimin</b> mbi punën dhe aktivitetet e KI	

**Këshilli i Investimeve** mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

Këshilli i Investimeve (KI) ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikatat në vend.

**KI kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë** dhe ka në përbërje përfaqësues të qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim.

Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.



# Hyrje

**K**y raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve kryesore të ndërmara nga Këshilli i Investimeve (KI) si dhe arritjeve kryesore në trajtimin e çështjeve të ndryshme të klimës së investimeve me interes për qeverinë dhe sektorin privat.

Këtë vit, pas konsolidimit të pozitës së tij si një platformë e strukturuar e dialogut me biznesin, KI u përzgjedh nga Qeveria për të diskutuar dhe konsultuar problematika të rëndësishme me komunitetin e biznesit.

Gjatë vitit 2019, anëtarësimi në KI kaloi disa ndryshime të rëndësishme. Në janar të 2019, për shkak të ndryshimeve në përbërjen e qeverisë, znj. Anila Denaj, u emërua Ministre e re e Financave dhe Ekonomisë, duke u bërë Kryetarja e re e KI. Anëtarësia pësoi ndryshime të tjera, duke mbyllur vitin me 17 anëtarë:

**5** përfaqësues nga Qeveria (përfshirë për herë të parë Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes),

**3** partnerë për zhvillim,

**3** anëtarë nga biznesi me status të përherëshëm (për herë të parë me status të tillë me kërkesë të vetë biznesit),

**4** anëtarë nga biznesi me mandat dy-vjeçar (statusi u ndryshua nga mandati i mëparshëm 1-vjeçar në mandat 2-vjeçar), për të siguruar vazhdimësinë e diskutimeve ndër mbledhje,

**2** anëtarë të posaçëm nga biznesi për çdo mbledhje (të cilët prekeshin drejtpërsëdrejti nga tema që do të trajtohej).

Gjithashtu, me Vendim të ri të Këshillit të Ministrave (maj 2019), KI uli shpeshtësinë e mbledhjeve plenare në vit në 4.

Në përputhje me objektivin e tij kryesor për rritjen e besimit midis aktorëve dhe institucionalizimin e dialogut mbi politikat për klimën e investimeve në vend, **puna e Sekretariatit u bazua në shtyllat e mëposhtme:**

» **Analizimin e çështjeve më emergjente të klimës së investimeve** - bazuar në konsultime mbarëkombëtare, hulumtimeve studimore, takimeve teknike, vrojtimeve, etj.

» **Lehtësimin e kushteve për një dialog të strukturuar** - përmes përzgjedhjes së duhur të përfaqësimit nga sektori publik dhe privat për diskutime konstruktive dhe angazhuese, si dhe gjithëpërfshirje në përcaktimin e axhendës së KI;

» **Avokimi për ndërmarrjen e politikave** - duke përpunuar masa/rekomandime prioritare për të mbështetur përmirësimet e nevojshme të politikave në lidhje me klimën e investimeve, dhe monitorimin e detajuar të zbatimit të këtyre rekomandimeve

Në përputhje me shtyllat e mësipërme, **aktivitetet dhe arritjet kryesore** gjatë periudhës së raportuar janë:

» **4 mbledhje plenare të KI;**

» **3 mbledhje në nivel teknik dhe 5 tryeza konsultuese** me biznesin në Tiranë, Korçë, Elbasan;

» **3 nota teknike për mbledhjet e KI dhe 2 vlerësime me karakter këshillues** me kërkesë të kryetares së KI;

» **80 intervista të drejtpërdrejta** me aktorë të ndryshëm (nga të cilët 48 nga sektori privat dhe 28 nga sektori publik);

» **Raporti i parë i monitorimit** mbi zbatimin e rekomandimeve të KI, 2015-2019;

» **Bashkëpunim me të paktën 20 shoqata biznesi** (shqiptare & të huaja) gjatë konsultimit të çështjeve ligjore dhe ekonomike;

» **Konsolidimin e bashkëpunimit me Këshillin Ekonomik Kombëtar (KEK)** duke krijuar sinergji në adresimin e çështjeve me ndikim në klimën e Investimeve.

Anëtarët e KI e konsiderojnë platformën e KI si organin më të strukturuar këshillimor në vend për përcjelljen e mesazheve të vërteta mbi çështje të lidhura me klimën e investimeve. Ndonëse matja e ndikimit mbetet e vështirë, shpërndarja e këtyre mesazheve luan një rol të rëndësishëm.

I gjithë informacioni në këtë dokument pasqyron aktivitetet vetëm për periudhën e raportuar.

## Analizë Lehtësim Avokim

# Aktivitetet

kryesore gjatë vitit 2019




**Mbledhje XVI**  
Siguria Ligjore mbi Pronën  
30 Maj 2019



**Anketa e KI**  
Mbi Klimën  
e Investimeve



**Mbledhje XVIII**  
Mbi Potencialet e Investimeve  
dhe Sektorët Prioritarë  
15 Tetor 2019



**Mbledhje XV**  
Mbi Inspektimet  
29 Janar 2019



**Tryezë e rrybullakët**  
Mbi Rimbursimin  
e TVSH-së



**Tryezë e rrybullakët**  
Mbi Konsultimin  
e Draftligjit të Unifikuar  
të Investimeve



**Mbledhje XVII**  
Konsultimi i Draftligjit  
të Fiskalizimit  
29 Gusht 2019



**Takime nëpër rrethe**  
Me bashki dhe  
dhoma tregtie



# Klima e Investimeve

Sipas INSTAT, ekonomia shqiptare u rrit me 2.9% gjatë periudhës janar - shtator 2019, duke shënuar një ngadalësim të ritmeve të rritjes pas trendit në rritje të filluar në 2013. Pavarësisht niveleve të ulëta të rritjes, punësimi, pagat dhe hyrjet e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) pësuan rritje. Sipas të dhënave të fundit nga INSTAT, shkalla e papunësisë ra në 11.4% në tremujorin e tretë të vitit 2019, nga 12.2% në tremujorin e tretë të 2018, ndërsa paga mesatare shënoi një rritje vjetore prej 3.7% gjatë së njëjtës periudhë. Sipas Bankës së Shqipërisë, flukset e IHD-ve, gjatë periudhës janar - shtator 2019 arritën në 810 mln EURO, me një rritje vjetore prej 7%.

Sipas Strategjisë së BERZH-it për Shqipërinë (2020-2025), për të shpejtuar konvergencën në nivelet e të ardhurave të BE-së, Shqipëria duhet të rrisë produktivitetin, duke e zhvendosur modelin e rritjes nga konsumi në investime dhe eksporte, veçanërisht në funksion të zhvillimeve të pafavorshme demografike, në kushtet e emigrimit dhe urbanizimit të shpejtë në Tiranë. Një klimë e përmirësuar biznesi është e nevojshme për të mbështetur diversifikimin dhe tërheqjen e IHD-ve, veçanërisht në sektorë si turizmi, prodhimi dhe agrobiznesi për të mundësuar rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Disa nisma u ndërmorën nga Qeveria në kuadër të përpjekjeve të saj të vazhdueshme që nga viti 2015 për të adresuar informalitetin në ekonomi dhe për të përmirësuar klimën e investimeve.

Në vitin 2019, MFE nisi për konsultim një iniciativë të re për fiskalizimin e cila synonte krijimin e një sistemi të ri të faturimit dhe monitorimit të transaksion-

eve të kryera nga biznesi në vend. Projektligji “Për faturat dhe sistemin e monitorimit të transaksioneve” iu nënshtrua një konsultimi të gjerë përmes tryezave të rumbullakëta, duke përfshirë një mbledhje të posaçme në KI. Qëllimi kryesor i këtij projektligji ishte ulja e nivelit të informalitetit në ekonomi, duke luftuar konkurrencën e pandershme dhe rritur efikasitetin e administratës tatimore. Projektligji u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me një afat të ri mbi fillimin e

procesit të fiskalizimit më 1 Shtator 2020, duke konfirmuar kështu skepticizmin e bizneseve mbi gatishmërinë e zgjidhjeve teknike për t'u zbatuar më herët.

Ligji 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” u miratua dhe u botua në gazetën zyrtare pavarësisht vetos nga Presidenti i Republikës. Qëllimi i ligjit është të promovojë zhvillimin ekonomik përmes projekteve të investimeve në nivelin qendror, lokal dhe rajonal, duke përdorur në mënyrë më efektive pronat shtetërore dhe duke mobilizuar kapitalin shtetëror dhe/ose privat.

Perceptimi i korrupsionit mbetet ende i lartë ndërsa Shqipëria humbi 7 pozicione në krahasim me vitin 2018 (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International, 2019) duke u renditur në pozicionin e 106-të nga 180 vende të përfshira në raport. Gjithashtu, nevojiten të ndërmerren shumë përmirësime në kuadër të treguesve të të bërit biznes (Raporti “Doing Business” i Bankës Botërore, 2020).

Së fundmi, Komisioni i BE-së u shpreh pozitivisht në lidhje me hapjen e negociatave të pranimit duke ritheksuar të njëjtin mendim pozitiv të dhënë më parë në vitin 2018 për Shqipërinë, duke nënvizuar arritjet historike të Reformës Gjyqësore.

rritje vjetore prej 3.7%

**Pavarësisht niveleve të ulëta të rritjes,** punësimi, pagat dhe hyrjet e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) pësuan rritje.



# Mbledhje Plenare



- » **A e ka rritur** portali elektronik i inspektimeve transparencën e inspektorateve?
- » **A është zbatuar** siç duhet në praktikë inspektimi online nga të gjithë inspektoratet?
- » **A janë bizneset** të mirëinformuara mbi mekanizmat e apelimit administrativ?

## Përmirësimi i inspektimeve - Si mund të zvogëlohet barra administrative për bizneset?

Inspektimet janë mekanizma të rëndësishëm për zbatimin praktik të ligjeve në vend. Nëse zbatohen mirë, ato zvogëlojnë “barrën administrative” të bizneseve, nxisin eksportet dhe krijimin e vendeve të punës, si dhe ofrojnë përfitime të tjera që rrjedhin nga vendosja e shtetit të së drejtës

Qëllimi kryesor i diskutimeve në KI ishte analiza e problematikave kryesore dhe ndikimit të inspektimeve si mjete të rëndësishme për formalizimin e ekonomisë, garantimin e rregullave të barabarta në treg, si dhe mbrojtjen e konkurrencës së ndershme, konsumatorit dhe mjedisit.

### REKOMANDIMET KRYESORE

- Përgatitja e një matrice të detajuar me të gjitha funksionet inspektuese dhe mbivendosjet përkatëse—si pjesë e fazës fillestare të hartimit të një plani konkret me afate kohore, institucione përgjegjëse, metodologji të qartësuar në lidhje me rishikimin e kuadrit ligjor sektorial nga ana e ministrive të linjës, në bashkëpunim me Inspektoriatin Qendror dhe inspektoratet shtetërore.
- Inventarizimi i plotë i kuadrit ligjor-rregullator i inspektimit dhe bërja i aksesueshëm lehtësisht për të gjitha grupet e interesit (*biznese, shoqata, inspektorë*) do të përmirësojë efikasitetin e inspektimeve.
- Asistencë ligjore falas dhe në distancë për subjektet e inspektimit nga ana e trupave inspektuese nëpërmjet përgatitjes së manualeve të thjeshta për rubrika të veçanta, sipas tipologjive të inspektimit dhe karakteristikave të bizneseve.
- Përgatitja/përditësimi i metodologjive të riskut mbi bazën e të dhënave më të fundit të monitorimit sipas sektorëve do të rrisë efincencën e inspektimeve dhe ulë barrën për bizneset.
- Përgatitja/përmirësimi dhe bërja publike e metodologjive të aplikuara nga inspektorët për vendosjen e masave administrative të përshtatshme dhe proporcionale, konsiderohet si një mjet për të kufizuar vendimet arbitrare dhe selektive.

“ Analiza e Sekretariatit përcjell qartë mesazhin që formalizimi, konkurrenca e ndershme, inspektimet por edhe koordinimi dhe ndër-veprimi institucional janë hallka të barazvlefshme të zinxhirit që përcakton qartë klimën e investimeve. ”

Edmond Spahiu, Albstar shpk, 29 janar 2019



“ Dy aspekte meritojnë një fokus të veçantë: i) sigurimi i disponueshmërisë së burimeve për të ofruar mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për biznesin, ii) synimi i një baraspeshimi të drejtë kosto-përfitim edhe në këndvështrimin e biznesit. ”

**Matteo Colangeli, BERZH,**  
29 gusht 2019

## Pse çështjet që lidhen me pronën mbeten kaq problematike në Shqipëri?

**S**ituata me të drejtat e pronës mbetet sfiduese në vend pasi lidhet me problematika të shumta, që nga pasaktësitë dhe mungesa e regjistrimit fillestar, dështimet e njëpasnjëshme institucionale apo edhe niveli i lartë i korrupsionit. Një qasje koherente, jo e fragmentuar ndaj problemeve të pronësisë, konsiderohet thelbësore për ekonominë e një vendi dhe përbën parakusht për stimulimin e investimeve. Çdo progres në këtë fushë, rit sigurinë ligjore për investitorët, nxit transparencën në mirëqeverisjen dhe luftën ndaj korrupsionit.

» **Cili** është vizioni aktual i qeverisë dhe shkalla e vullnetit politik për zgjidhjen e problematikave në lidhje me regjistrimin e pronës?

» **Çfarë** sugjeron biznesi për priorizimin e ndërhyrjeve?

Mungesa e sigurisë juridike mbi pronën ka prekur zhvillimin e sektorit të bujqësisë për shkak të fragmentimit të tokës, si dhe ka penalizuar sektorin e turizmit për mungesë të investimeve në shkallë të gjerë. Problematikat e pronësisë kanë nxitur mashtrime në tregun e pasurive të paluajtshme dhe kanë ngjallur konflikte sociale duke prekur kështu individin, biznesin si edhe vetë shtetin.

### REKOMANDIMET KRYESORE

- Hartimi i një Plani Veprimi që specifikon aktivitetet/afatet/faturën financiare/përgjegjësitë/treguesit e monitoruar dhe ndërhyrjet në të gjitha nivelet për konsolidimin e regjistrimit të pronave dhe dixhitalizimin e tij.
- Hartimi i një liste prioritare të regjistrimit të pronës shtetërore (pjesë e Planit të Veprimit).
- Kadastra Dixhitale për pronat shtetërore të jetë online dhe pa kufizim aksesit për publikun e gjerë.
- Krijimi i një grup pune nga bashkitë në vend në lidhje me ecurinë e proceseve të transferimit, inventarizimit dhe regjistrimit të plotë të pronave të tyre.
- Një vizion bashkëkohor për një standard të ri të regjistrimit “të pronës” që merr në konsideratë edhe priorizimin e ndërhyrjeve për investime nga ana e sektorit privat.
- Monitorimi i progresit të reformës së pronësisë - krijimi i instrumentave monitorues, dhe publikimi i raporteve monitoruese
- Konsultimi publik me palët dhe grupet e interesit i projektligjit “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”.

## A jemi gati për një sistem të ri fiskalizimi?

**P**rojektligji “Mbi Faturat dhe Sistemin për Monitorimin e Transaksioneve” (korrik 2019) solli disa risi në sistemin fiskal, të tilla si krijimin e një regjistri të subjekteve tatimpaguese që lëshojnë fatura, duke mundësuar në kohë reale kontrollin e përmbajtjes së faturave dhe monitorimin e tyre pavarësisht nëse këto fatura paguhen menjëherë me para në dorë ose jo.

» **Cilat** janë kostot për biznesin?

» **A janë** gati të gjithë elementët teknikë për të siguruar funksionimin pa probleme?

### SUGJERIMET KRYESORE

- Lejueshmëri për afate dhe faza të përshtatshme, si dhe njëfarë fleksibiliteti në afatet e zbatimit;
- Të publikohen detajet në përcaktimin e analizës së kosto-përfitimit si për administratën publike ashtu edhe për biznesin;
- Fushatë edukimi për kryerjen e transaksioneve online dhe përdorimin e kartave të kredit, si edhe mbi rezultatet pozitive që vijnë nga zbatimi i këtij ligji;
- Konsultimi i gjerë me palët e interesit është veçanërisht i rëndësishëm, konsideruar gamën e gjerë të ndryshimeve të parashikuara;
- Sigurimi i disponueshmërisë së burimeve për të ofruar mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për biznesin;
- Zbatimi i ligjit të fillojë fillimisht me transaksionet e prokurimit publik (segmenti B2G), të vazhdojë me bizneset e mëdha (segmenti B2B) dhe më pas me bizneset e mesme dhe të vogla (segmenti B2C);
- Nevojitet të konsultohen me sipërmarrësit udhëzimet pasuese, gjë do të qartësonte siç duhet edhe pjesën e zbatimit të këtij ligji;
- Të fillohet një projekt pilot në një sektor të caktuar të ekonomisë dhe në një qytet të rëndësishëm;
- Bashkëveprimi i këtij draft ligji me ligje të tjera, të tilla si Ligji ‘Mbi TVSH’ dhe Ligji ‘Mbi Procedurat Tatimore’, duhet të studiohet më mirë, për të shmangur ambiguitetet apo ndërhyrje shtesë.





## Si të stimulohet debati mbi opsionet e zhvillimit ekonomik? Energjia, Turizmi, Agro-përpunimi, Dixhitalizimi — 4 fusha të propozuara si sektorë prioritarë

**N**ga hulumtimi i raporteve dhe konsultimet me CEO të 17 kompanive (vendase dhe të huaja) që operojnë në Shqipëri, Sekretariati vërejt se faktorët që kanë nevojë për përmirësim në kuadër të përmirësimit të klimës së investimeve në vend janë:

- Mungesa e qëndrueshmërisë në ruajtjen e fokusit të nevojshëm të politikave sipas vizionit të deklaruar nga ana e politikë-bërësve;
- Mungesa e të dhënave apo vlerësimeve të impaktit të strategjive si p.sh. Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve;
- Sfida në lidhje me disponibilitetin dhe cilësinë e fuqisë punëtore kundrejt kërkesave të tregut;
- Problematikat në lidhje me të drejtën e pronësisë janë një pengesë e madhe për tërheqjen e investimeve në sektorët strategjikë;
- Vështirësi në materializimin e legjisllacionit të miratuar në masa dhe veprimtari konkrete.

» **A është** momenti i duhur për të diskutuar nëse ekonomia shqiptare ka nevojë për një model të ri të zhvillimit? Disa nga strategjitë më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik janë afër përfundimit, çfarë duhet të bëjmë më pas?

» **A kemi** nevojë për një strategji për tërheqjen e kapitalit të huaj në vend në sektorët me përparësi?

» **A ka** nevojë për ri-prioritizim duke marrë parasysh pozicionimin e vendit në tregjet rajonale, evropiane dhe më gjerë?



### REKOMANDIMET KRYESORE

- Mbështetja e NVM-ve të jenë fokusi kryesor i modelit dhe i politikave mbështetëse për zhvillim të qëndrueshëm.
- Saktësimi i vizionit nga ana e qeverisë mbi fokusin e prioritetëve (në nivel qendror dhe vendor).
- Konsolidimi dhe depolitizimi i institucioneve në koherencë me sektorët prioritarë për të siguruar “memorien institucionale” dhe arritur potencialin e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ngritja e një institucioni/platforme që të mundësojë koordinimin ndër-sektorial e të shtyjë përpara axhendën dixhitale, kërkim dhe zhvillim si dhe rritjen e kapaciteteve drejt sofistikimit të biznesit.
- Krijimi i politikave konkrete incentivuese mbi arsimin profesional me fokus në teknologjinë e informacionit dhe aftësitë dixhitale.
- Qeveria të mundësojë dhënie me qera të godinave shtetërore në mbështetje të krijimit të qendrave të trajnimit për ridimensionimin e aftësisë të fuqisë punëtore në përputhje me kërkesat e tregut.

“ AmCham shpreh gatishmërinë për të qenë pjesë e një grupi pune përmes KI apo MFE dhe të kontribuojë në materializimin e ideve përkatëse në një strategji për ta bërë Shqipërinë konkurruese në rajon. ”

Enio Jaço, AmCham,  
15 tetor 2019

# Tryeza Konsultimi



## Tryezë Konsultimi “Mbi Procedurat e Rimbursimit të TVSH-së” – Çfarë mund të përmirësohet më tej?

**S**a i përket luftës kundër informalitetit, kompanitë u shprehën se biznesi i ndershëm është aleati më i mirë për qeverinë. Ata kërkuan krijimin e një grupi pune, ndoshta përmes Sekretariatit të KI ose MFE, për të ngritur çështjet në mënyrë të strukturuar, sipas specifikave të sektorit.

**Rezultati**  
**Ndërgjegjësimit**  
dhe  
**mirëkuptimit**  
nga NVM-të mbi strategjinë e re të rimbursimit të TVSH-së nga MFE.

### SUGJERIMET KRYESORE TË BIZNESIT

- Parakushti themelor - rimbursimi në kohë i TVSH-së për të shmangur problematikat brenda ndërmarrjeve në kryerjen e pagesave të tjera;
- Për sektorin fason të konsiderohet kompensimi me tatimin mbi të ardhurat personale dhe kompensimi me sigurimet shoqërore në rast të vonesave në rimbursimin e TVSH;
- Ndikimi ekonomik për shkak të zhvlerësimit të monedhës së euros;
- Industria e bimëve aromatike dhe medicinale të ri-përfshihen në skemat e financimit kombëtar dhe ndërkombëtar (si IPARD Like, IPARD 2, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural);
- Disa opsione mbi tatimin e rrogave të punonjësve dhe nivelin e tyre në sektor; më shumë subvencione nga shteti, etj.;
- Çështje të tjera jo-fiskale, si p.sh. pagesat për tarifa shtesë (trajnimi i personelit, leja mjedisore, testimi i ujit të pijshëm, sistemi elektrik, etj.).

## Tryezë konsultimi

mbi Draft Ligjin e Unifikuar të Investimeve



**D**iskutimi u mbajt në terma të përgjithshëm mbi parimet e projektligjit të unifikuar për investimet, por edhe në nivel teknik. Shumica e pjesëmarrësve kërkuan që ligji të ofrojë një sqarim më të mirë të procedurave përkatëse për të lënë sa më pak hapësirë për përcaktimin e tyre përmes akteve nënligjore përkatëse.

**Dialog i strukturuar** me rekomandime konkrete bazuar në komente paraprake të mbërritura me shkrim nga biznesi për grupin e punës dhe Qeverinë.

### SUGJERIMET KRYESORE

- Një përcaktim më i mirë i projektligjit të propozuar;
- Përgatitja e një ligji gjithëpërfshirës me një paketë të plotë të akteve nënligjore; hartimin e qartë të dispozitave ligjore, veçanërisht atyre që lidhen me nxitësit, sektorët strategjikë;
- Standarde minimale për trajtimin e ankesave të investitorëve dhe vendosja e mekanizmit përkatës;
- Kujdes me shpronësimet e pronave në favor të investimeve strategjike;
- Kujdes me sundimin e ligjeve të tjera sektoriale;
- Kujdes me monitorimin e investimeve strategjike.

# Rekomandime të përmbushura gjatë 2019





## 34 rekomandime të përmbushura në fusha të ndryshme

### VAZHDIMI I REFORMAVE

**Reforma e inspektiveve** përparoi drejt unifikimit të praktikave administrative për inspektimin në nivelin qendror dhe lokal. Gjithashtu, listat e verifikimit u hartuan për të gjithë inspektoriatet shtetërore.

Qartësimi i vizionit mbi **objektivat e politikës në sektorin e turizmit** përmes miratimit të "Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm 2019 – 2023", i cili do të lehtësojë procesin e formalizimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

**Lufta kundër Informalitetit:** Një vendim i ri u mor nga Këshilli i Ministrave mbi formalizimin e strukturave të turizmit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë prezantoi një aplikacion, "Stop Informalitetit" përdorur nga rreth 13.800 përdorues—të ndërgjegjësuar mbi ndikimin e tyre në luftën kundër informalitetit.

**Reforma e derregullimit** pati një zhvillim pozitiv këtë vit, përmes thjeshtimit të procedurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me zbatimin e shërbimit "Doganat pa letër" e cila prek 93% të të gjitha subjekteve që kryejnë shërbime doganore. Gjithashtu, u vërejt një rritje e numrit të aplikacioneve dhe certifikatave të lëshuara krejtësisht në internet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve - 12 dokumente të përdorura nga rreth 90.000 përdorues.

### NXITËSIT FISKALË

Ndryshime ligjore për thjeshtimin e **skemës së kompensimit të TVSH-së** për prodhuesit bujqësorë dhe ulje të TVSH-së nga 20% në 6% për këtë kategori. Gjithashtu, furnizuesit e inputeve bujqësore (si p.sh. plehra, pesticide, fara, fidanë, etj.), u përjashtuan nga TVSH-ja që prej janar të vitit 2019.

### MBËSHTETJE PËR AFTËSITË E FUQISË PUNËTORE DHE INOVACIONIN


**Cilësia e aftësive punëtore** – Gjatë vitit 2019, shumica e ndërhyrjeve publike të Kryetares së KI, ndjekur nga masa përkatëse të qeverisë (MFE) u përqendruan në partneritetin universitet-biznes-qeveri, si një përparësi për investimet në vend. Këto ndërhyrje konsistuan në mbështetje të qendrave të inovacionit dhe qendrave të teknologjisë përmes futjes së instrumenteve të rinj (si p.sh. panairë pune në universitete me bashkëpunimin e dhomave të tregtisë, mbështetje dhe punësim për studentët e ekselencës, rritje të bashkëpunimit nga ana e zyrave të karrierës me universitetet dhe bizneset).

### RRITJA E KAPACITETEVE TË BURIMEVE NJERËZORE


**Rritja e kapaciteteve** për administratën tatimore dhe ngritja e sporteve për të ofruar informacion për tatimpaguesit mbi procedurat tatimore dhe kërkesat përkatëse.

## Grupe të reja pune për ndjekjen e rekomandimeve dhe diskutimeve të Këshillit të Investimeve

**K**atër rekomandime të rëndësishme të paraqitura nga KI gjatë vitit 2019 tashmë janë formalizuar dhe zbatuar nga Qeveria, siç ishte ngritja dhe zyrtarizimi i tre grupeve të punës me pjesëmarrje të disa ministrive të linjës dhe institucioneve publike, për të ndjekur rekomandimet e KI për zhvillimin e sektorëve të veçantë, konsideruar me potencial të lartë për gjenerimin e investimeve dhe rritjes ekonomike.




**OBJEKTIVI KRYESOR:** Diskutim mbi masat konkrete që duhet të ndiqen për arritjen e objektivave të Strategjisë së Energjisë 2018-2030 dhe Planit Kombëtar të Konsoliduar të Veprimit 2019-2020 për burimet e rinovueshme të energjisë në drejtim të promovimit dhe mbështetjes së investimeve të qëndrueshme në vend.  
**OBJEKTIVA TË TJERA:** Diskutimi i rekomandimeve të KI "Për potencialet e investimeve dhe sektorët prioritarë" (4 tetor 2019)



**OBJEKTIVI KRYESOR:** Propozojë një plan pune të koordinuar me të gjitha palët e përfshira me qëllimin përfundimtar të krijimit të kushteve të favorshme për investime të qëndrueshme në sektorin e agropërpunimit.


**OBJEKTIVA TË TJERA:** Diskutimi i rekomandimeve të KI "Për potencialet e investimeve dhe sektorët prioritarë" (4 tetor 2019)









**OBJEKTIVI KRYESOR:** Të vlerësojë dhe propozojë një plan pune të koordinuar me të gjitha palët e përfshira me qëllimin përfundimtar stimulimin e axhendës dixhitale dhe krijimin e kushteve të favorshme për investime në sektor.

**OBJEKTIVA TË TJERA:** Diskutimi i rekomandimeve të KI "Për potencialet e investimeve dhe sektorët prioritarë" (4 tetor 2019)

# Dokumente

 Kliko titullin e dokumentit për ta shkarkuar.






## JANAR 2019

-  Rekomandimet e KI për 2018
-  Mbledhje XV - Axhenda
-  Mbledhje XV – Prezantim PPT ‘Mbi Inspektimet’
-  Mbledhje XV – Nota Teknike ‘Mbi Inspektimet’
-  Mbledhje XV - Matrica e Rekomandimeve
-  Mbledhje XV - Minutat


## PRILL 2019

-  Tryezë konsultimi “Mbi Rimbursimin e TVSH-së” - Minutat


## MAJ 2019

-  Mbledhje XVI - Axhenda
-  Mbledhje XVI – Prezantim PPT ‘Mbi Investimet dhe Sigurinë Ligjore të Pronës’
-  Mbledhje XVI – Notë Teknike ‘Mbi Investimet dhe Sigurinë Ligjore të Pronës’
-  Mbledhje XVI - Matrica e Rekomandimeve
-  Mbledhje XVI – Minutat

## QERSHOR 2019






-  Përmbledhje e komenteve të tryezës e rumbullakët për konsultimin e projektligjit të unifikuar të investimeve

## GUSHT 2019

-  Mbledhje XVII - Axhenda

-  Mbledhje XVII – Përmbledhje Ekzekutive
-  Mbledhje XVII – Minutat
-  Vështirim mbi Indikatorët Ekonomik të Shqipërisë, janar-qershor 2019

## TETOR 2019

-  Mbledhje XVIII - Axhenda
-  Mbledhje XVIII – Dokument Diskutimi “Mbi Potencialet e Investimeve dhe Sektorët Prioritarë”
-  Mbledhje XVIII – Matrica e Rekomandimeve
-  Mbledhje XVIII – Prezantim PPT “Mbi Potencialet e Investimeve dhe Sektorët Prioritarë”
-  Mbledhje XVIII – Minutat

## PUBLIKIME

-  Buletin Informues (2018)
-  Raporti i Aktiviteteve për vitin 2018
-  Gjetjet e Anketës “Mbi Disa Aspekte të Klimës së Investimeve” (2019)
-  Gjetjet e Anketës “Mbi Bashkëveprimin Bashki-Biznes” (2019)
-  Raporti i Monitorimit të Rekomandimeve 2019
-  Komente nga Anëtarë të KI 2018-2019
-  Fakte dhe Shifra 2019
-  Matricë krahasuese mbi nxitësit e investimeve në Ballkanin Perëndimor (2019)

# Komunikim dhe vizibilitet

**D**uke qenë një platformë dialogu publik-pri-  
vat me 3 palë të përfshira, KI ka tërhequr  
audiencë nga qeveria, komuniteti i biznesit  
dhe partnerët për zhvillim. Kur u py-  
etën mbi vizibilitetin dhe ndikimin e KI, anëtarët e KI  
pranuan ndikimin e tij në rritjen e transparencës dhe  
dialogut të konsultimeve në vend. Krahasuar me vitin  
2018, KI rriti dukshëm vizibilitetin e tij në internet gjatë  
vitit 2019, siç tregohet në figurat më poshtë.

## FAQJA E INTERNETIT

- » Rritje prej 59% të përdoruesve të faqes së internet krahasuar me vitin 2018
- » Rritje në shikimin e faqes me 48% krahasuar me vitin 2018
- » 680 të abonuar
- » 9 fushata informuese (pas publikimit të lajmeve në faqe) me një hapjeje mesatare prej 37%.

## MEDIAT SOCIALE

- » Aktiv në 3 platforma: Facebook, Twitter, LinkedIn
- » Numri total i ndjekësve: 1,140

## INTERVISTA NË MEDIA

Intervistë e Drejtores së Sekretariatit në Business Magazine “Përpyekjet e KI në Përmirësimin e Dialogut Publik në kuadër të Klimës së Investimeve: Sfidat dhe Përparësitë Kryesore”

## AKTIVITETE DHE NETWORKING

Sekretariati ka vendosur dhe ruajtur kontakte me një numër të madh palësh të interesuara, duke përhapur gjithashtu ndërgjegjësimin mbi punën dhe arritjet e KI jashtë kryeqytetit.

## KI njihet si një mbështetës i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve të biznesit nga partnerët e tjerë

Helvetas/Risi Albania, IFC, institucionet e qeverisjes qendrore, bashkitë lokale, etj. Kanë

informuar herë pas here audiencën e tyre për aktivitetet e ndërsjella të zhvilluara me KI, duke rritur kështu bazën e audiencës së KI.

## Dokumentet teknike të KI-së bëhen burim reference nga studiuesit ekonomikë

Materialet teknike të prodhuara nga Sekretariati janë marrë në konsideratë nga institucione të ndryshme kërkimore, duke i përmendur në punimet e tyre përkatëse.

## KOMUNIKATA SHTYPI

-  Mbledhje XV ‘Mbi Inspektimet’
-  Tryezë konsultimi mbi Strategjinë e Rimbursimit të TVSH-së dhe Informalitetin
-  Grup në nivel teknik ‘Mbi Nxitjen e Investimeve dhe Sigurinë Ligjore të Pronës’
-  Mbledhje XVI ‘Mbi Nxitjen e Investimeve dhe Sigurinë Ligjore të Pronës’
-  Mbi Ligjin e Unifikuar të Investimeve, Konsultim me Biznesin
-  Mbledhje XVII ‘Konsultim i draft Ligjit mbi Fiskalizimin’
-  A janë konsultuar bizneset mbi taksat dhe tarifën e reja të vendosura nga bashkitë? A marrin bizneset shërbimet e duhura krahasuar me tarifën vendore që iu paguajnë bashkive?
-  Mbledhje në nivel teknik “Mbi nxitjen e investimeve dhe burimeve të rritjes ekonomike”
-  Mbledhje XVIII “Mbi Potencialet për Investime dhe Sektorët Prioritarë”

I gjithë informacioni në lidhje me aktivitetet dhe arritjet e KI është publikuar në mënyrë transparente në faqen e KI në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.

# Angazhimi i aktorëve

**Angazhimi i aktorëve nga sektori privat** u arrit përmes pjesëmarrjes:

- në konsultimin e ndryshimeve ligjore në lidhje me klimën e investimeve,
- në anketën vjetore të KI,
- në konsultimin dhe validimin e gjetjeve dhe rekomandimeve, etj.

Bashkëpunimi u forcua më tej me shoqatat kryesore të biznesit në vend përmes organizimit të takimeve specifike sektoriale me anëtarët e tyre ose me mbledhjen e komenteve me shkrim (p.sh. FIAA, AmCham, Confindustria Albania, DIHA, CCI Albania etj.).

Ndërsa **angazhimi i aktorëve të sektorit publik** u arrit në formën e:

- bashkë-organizimit të tryezave të rrumbullakëta me përfaqësuesit e biznesit,
- pjesëmarrjes së ministrave të qeverisë/zëvendës ministrave/drejtuesve të institucioneve (jo anëtarë të KI) në diskutimet e mbledhjeve plenare të KI (p.sh. Ministri i Energjisë, Zëvendës Ministri i Turizmit, Zëvendës Ministri i Bujqësisë, Drejtori i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës),
- konsultimit të gjetjeve dhe rekomandimeve gjatë fazës përgatitore të konsultimit,
- reportimit të statusit të zbatimit të rekomandimeve të KI, etj.

Për herë të parë, grupet e punës të sapoformuara (dhjetor 2019), përfshijnë përfaqësues të akademisë, përfaqësues të ministrave të tjera të linjës si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Bujqësisë, etj., gjë që pritet të rrisë fushën e punës dhe ndikimin e KI.



# Të tjera

## Avokim dhe ndërgjegjësimit

### PREZANTIMI I ROLIT DHE NDIKIMIT TË KI NË QEVERISJEN E MIRË TË VENDIT TEK ANËTARËT E RINJ

Pas emërimit të anëtarëve të rinj të biznesit të KI për periudhën 2019-2021, Sekretariati mbajti takime prezantuese për të siguruar angazhimin e anëtarëve të rinj të biznesit në takimet e ardhshme plenare të KI.

### NETWORKING DHE AVOKIMI ME AKTORË TË NDRYSHËM

Gjatë vitit 2019, Sekretariati mori pjesë dhe kontribuoi në disa konferenca dhe takime teknike për të avokuar dhe nxitur ndjekjen e rekomandimeve të KI, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin për pengesat e ndryshme të biznesit të evidentuara pranë Sekretariatit gjatë konsultimeve të shumta.

### FORCIM TË BASHKËPUNIMIT ME ATASHE TË HUAJA NË SHQIPËRI

Këtë vit, KI forcoi bashkëpunimin e tij me disa atashe të huaj në vend (si p.sh. atashenë e Ambasadës Italiane, Ambasadës Greke, Ambasadës Hungareze, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, Ambasadës Franceze, etj.), në veçanti sa i përket projektligjit të unifikuar të investimeve dhe promovimit të investimeve në vend.





## Vrojtim mbi klimën e Investimeve, 2019

Anketat janë instrumente të vlefshme për angazhimin dhe gjithëpërfshirjen e biznesit (sipas metodologjisë poshtë-lart), tashmë pjesë e punës së KI-së që prej vitit 2015. Anкета e KI-së për vitin 2019 u përgatitur nga Sekretariati në formën e një pyetësi të strukturuar, e cila u plotësua përmes internet në mënyrë rastësore nga 300 kompani në të 12 qarqet e Shqipërisë. Qëllimi i studimit ishte të inkurajonte dialogun gjithëpërfshirës bazuar mbi dëshmi të biznesit në lidhje me shqetësimet që ato hasnin në kuadër të klimës së investimeve:

- » **Inspektimi tatimor, transparencja dhe komunikimi me administratën tatimore**
- » **Rimbursimi i TVSH-së**
- » **Informaliteti**
- » **Bashkëveprimi midis biznesit dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore**

Në seksionin e fundit të anketës, bizneset u pyetën mbi transparencën e bashkive ndaj biznesit, ofrimit të shërbimeve nga bashkitë kundrejt tarifave të paguara nga biznesi si dhe ofrimin e shërbimeve elektronike nga bashkitë dhe përdorimin përkatës nga bizneset. Këtë vit, vrojtimi u plotësua kryesisht nga kompanitë e mëdhaja, kompani që operojnë në sektorin e shërbimeve dhe kompani në qarkun e Tiranës. Sekretariati bashkëpunoi me Universitetin Epoka për asistencë në promovimin e anketës, përpunimin statistikor dhe validimin e gjetjeve.



## Programi i internshipit, 2019

Për të tretin vit, Sekretariati bashkëpunoi me sukses me universitete me emër në Tiranë, dhe në veçanti me Universitetin e Epoka, bazuar mbi një Memorandum Mirëkuptimi nënshkruar midis dy institucioneve. Gjatë vitit 2019, 8 studentë dhanë kontributin e tyre në **promovimin e anketës tek bizneset, si dhe mbështetjen në përgatitjen e metodave për përpunimin e të dhënave me qëllim monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të KI.**



Pjesëmarrja në këtë program internshipi ishte përvoja ime e parë profesionale jashtë një ambienti akademik. Gjatë këtij programi, fillova të kuptoj se si funksionon një institucion në realitet, një përvojë e domosdoshme për çdo të ri që dëshiron t'i përshtatet sa më mirë tregut të punës. Stafi i Sekretariatit ishte shumë mbështetës për çdo problem që hasnim dhe i gatshëm të na mësonte çdo hap në procesin e gjatë dhe të komplikuar të përfundimit me sukses të një studimi të kësaj madhësie, i cili përfshinte mijëra biznese në Shqipëri.

**Tomas Muça,**  
Praktikant, korrik-gusht 2019



# Planet për të ardhmen

**Si** mund të ndihmojnë bashkitë në zhvillimin e ekonomisë - Axhenda për mbledhjen e ardhshme të KI

**N**ë mbledhjen e parë për vitin 2020, Këshilli i Investimeve pritet të trajtojë çështje që lidhen me klimën e investimeve në kontekstin e zvogëlimit të barrierave administrative në nivel vendor për biznesin. Të dhëna paraprake u mbledhën edhe nga vrojtimi i KI-së për vitin 2019. Gjatë muajit dhjetor 2019, në bashkëpunim me Shoqatën për Autonomi Vendorë, Sekretariati organizoi tryeza konsultimi me përfaqësues të Bashkive: Tiranë, Elbasan, Korçë dhe Shkodër. Tryeza konsultimi u mbajtën edhe me biznesin nëpërmjet bashkëpunimit me Bashkinë e Korçës dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë. Kjo temë pritet të trajtohet nga KI në fund të muajit janar 2020.


## AXHENDA PËR VITIN 2020

Axhenda për vitin e ardhshëm u vendos përmes votimit të anëtarëve nga një listë me propozime të përgatitura nga Sekretariati. Dy temat më të votuara, të cilat pritet të jenë pjesë e axhendës së KI për 2020, janë:

- » **Produktet “Made in Albania” dhe konkurrenca e tyre në rajon**
- » **Zona e lira ekonomike (TEDA-t) - Qasje krahasuese, Shqipëria vs Maqedonisë së Veriut vs. Serbisë**



# Numra të rëndësishëm, 2019



# Anëtarë të KI gjatë 2019

Anëtar, Institucion Shtetëror	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Anëtar, Institucion Shtetëror	Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Anëtar, Institucion Shtetëror	Banka e Shqipërisë
Anëtar, Institucion Shtetëror	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
Anëtar, Institucion Shtetëror	Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
Anëtar, Partner për Zhvillim	Banka Botërore
Anëtar, Partner për Zhvillim	Delegacioni i BE-së në Shqipëri
Anëtar, Partner për Zhvillim	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
Anëtar, Partner për Zhvillim	Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)
Anëtar i Biznesit me Mandat të Përhershëm	Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë Tiranë
Anëtar i Biznesit me Mandat të Përhershëm	Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)
Anëtar i Biznesit me Mandat të Përhershëm	Dhoma Shqiptare e Diasporës
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA)
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri (DIHA)
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Confindustria Albania
Anëtarë Biznesi me Mandat të Posaçëm	Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) A.E.Distribution sh.p.k. Vodafone Albania Teuta sh.p.k.



Albania  
Investment  
Council


Improving Transparency and Investment Climate

Dizajni Grafik: **Eduard Bujari**

# RAPORT mbi AKTIVITETIN e KI 2019

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri, T. +355 692631300  
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



**Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO**

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).